



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 27, datë 27.01.2021

**PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**V E N D O S I:**

1. **Z. Genti Xholi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Z. Genti Xholi do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga data 27.01.2021 - 26.04.2021.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Genti Xholi do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Të njoftohen për këtë vendim Z. Genti Xholi, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

